

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga VIT Korn Holding B.V., me seli të regjistruar në Pieter Baststraat 6X, 1071 TV Amsterdam, Mbretëria e Holandës, përmes avokatit Filip Zafirovski nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 03.06.2026, miratoi këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin VIT Korn Holding B.V., me seli të regjistruar në Pieter Baststraat 6X, 1071 TV Amsterdam, Mbretëria e Holandës, do të fitojë kontroll mbi Shajkashka SHPK, me seli të regjistruar në Zona Industriale – Rruga Çurushki nr. 3, Zhabal, Republika e Serbisë, përmes shitblerjes së pjesëve të kapitalit, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe **është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.**

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë takse administrative për njoftimin për përqendrim në shumë prej 6.000,00 denarë, si dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra dhe programi i të hyrave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

Arsyetim

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më 11.05.2026, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftim për përqendrim nga VIT Korn Holding B.V., me seli të regjistruar në Pieter Baststraat 6X, 1071 TV Amsterdam, Holandë, me të cilin VIT Korn Holding B.V. do të fitojë kontroll të vetëm mbi Shajkashka SHPK, me seli të regjistruar në Zonën Industriale – Rruga Çurushki nr. 3, Zhabal, Republika e Serbisë, nëpërmjet shitblerjes së pjesëve të kapitalit.

Komisioni filloi shqyrtimin e njoftimit në ditën e pranimi të tij dhe, në bazë të të dhënave të paraqitura në njoftimin për përqendrim dhe dokumentacionit bashkëlidhës, konstatoi si vijon:

Aktivitetet themelore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

VIT Korn Holding B.V. është pjesë e grupit të shoqërive MK Group dhe është shoqëri holding që bën pjesë në divizionin e MK Group aktiv në sektorin e bujqësisë. Veprimtaria e shoqërive

në kuadër të MK Group është e organizuar në pesë divizione: divizioni i bujqësisë, divizioni financiar, i cili përfshin veprimtarinë bankare, brokerimin dhe të bursës, hotelerinë dhe menaxhimin e pasurive të paluajtshme, divizioni energjetik, i cili përfshin prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme (era dhe biomasa), si dhe divizioni i përbërë nga shoqëri, veprimtaria e të cilave lidhet me ofrimin e mbështetjes afariste për të gjithë sistemin e MK Group.

MK Group është e pranishme në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërisë së saj të varur MK Suntastik SHPKNJP Shkup, me seli në bulevardin „Partizanski Odredi“ nr. 155-1/mezanin 3, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, me veprimtari prioritare 35.120 – prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. MK Group në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjithashtu gjeneron të ardhura nga shitja ndërkufitare e produkteve të mishit, perimeve të ngrira dhe sheqerit përmes shoqërive me seli në Serbi – PIK Beçej, Sunoko/Kristal Sunoko dhe Karnex.

Fabrika e Sheqerit Shajkashka SHPK zotëron një fabrikë për prodhimin e sheqerit, e cila ndodhet në Zhabal, Serbi. Megjithatë, fabrika e sheqerit nuk ka qenë aktive gjatë gjashtë viteve të fundit dhe aktualisht shërben vetëm si objekt për paketimin dhe magazinimin e produkteve, përkatësisht të sheqerit që prodhohet nga shoqëria e lidhur Crvenka Fabrika e Sheqerit SHPK Crvenka, me seli në adresën Masarikova nr. 7, Crvenka, Kulla, Republika e Serbisë. Crvenka Fabrika e Sheqerit SHPK Crvenka nuk është objekt i transaksionit të propozuar.

Fabrika e Sheqerit Shajkashka SHPK nuk ka shoqëri të varur, degë apo përfaqësi të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ushtron asnjë veprimtari në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafët (2), (3) dhe (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat, gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i paraqitur, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të njëjtin, pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ